



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 129, datë 30.03.2020

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Engjëllushe Tahiri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurëve: {...}, {...}; të akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 78/1-22-25, 278/1, 274-25, 150-25 dhe 89-25 të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Suela Dashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore që iu përket palëve: paditëse: Kristina Arhile Papagjika; të paditur: {...}, {...}, etj.; person i tretë: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Sarandë; me objekt: “1.Marrje e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestro konservative në pronësinë e regjistruar me nr.pasurie 5/224, vol.54. 2.Anulimin pjesërisht të vendimit nr.5, datë 16.03.1999 të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave të Rrethit Sarandë”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Suela Dashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; me Objekt: “Gjykimin e procedimit penal nr.424 të vitit 2019, kundër të pandehurve të akuzuar përkatësisht: {...} për kryerjen e veprave penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal; {...} i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Sokol Shehu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore që iu përket palëve: kërkuar: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; i pandehur: {....}; akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 76, 278/3 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarii Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Jak Ndoka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore që iu përket palëve: kërkuar: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; i pandehur: {....}; akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi dhe Tritan Hamitaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurve: {....}, {....}, {....}, {....}, {....}; të akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Ndihmë për kalim të paligjshëm kufiri”.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Alma Kolgjoka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurit: {....}; i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 140 (nëntë herë), 88 (dy herë), 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR